

VENDIM
Nr. 608, datë 29.7.2020

**PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT TË
PERSONAVE TË DALË TË PAPUNË SI PASOJË E COVID-19**

(Ndryshuar me VKM nr. 699, datë 10.9.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19, nga data 10 mars 2020 deri në datën 31 dhjetor 2020.

2. Programi, sipas pikës 1, të këtij kreu, zbatohet në përputhje me nevojat individuale të punëkërkuës të papunë për t’u integruar në tregun e punës dhe me planin individual për punësimin e tij.

II. KRITERET E KËRKESËS

1. Punëkërkuësit me të drejtë përfitimi për programet, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të kreut III, janë të gjithë punëkërkuësit e papunë që kanë dalë të papunë si pasojë e COVID-19, të evidentuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe të regjistruar në zyrën e punësimit. Ndërsa, punëkërkuësit me të drejtë përfitimi për programin, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të kreut III, janë ata të cilët deklarojnë që kanë qenë të punësuar, por nuk evidentohen si të tillë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe regjistrohen në zyrën e punësimit.

2. Punëkërkuësi, pjesëmarrës në programet sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, nuk mund të zëvendësohet.

3. Një punëkërkuës mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program.

4. Punëdhënësit me të drejtë kërkesë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Të jenë *persona fizikë apo juridikë të regjistruar*;

b) Të jenë subjekt i pagimit të taksave dhe të jenë të regjistruar si punëdhënës pranë autoriteteve tatimore;

c) Të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vitet e fundit përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi;

ç) Të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës;

d) Vendi i punës, i financuar nga ky program, duhet të vijë si rezultat i rritjes së fuqisë punëtore në aktivitetin e punëdhënësit;

dh) Të jenë *persona fizikë apo juridikë*, të cilat nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore para datës 10 mars, në bazë të akteve normative në fuqi ose, në momentin e kërkesës për këtë program, të vërtetojnë se:

i. kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullta në shlyerjen e tyre;

ii. kanë shlyer detyrimet por kanë ende pa paguar gjokat;

iii. kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ e në procese gjyqësore me organet tatimore.

III. PROGRAMET, PËRFITUESIT DHE MBËSHTETJA

1. Programi i punësimit përmban elementet, si më poshtë vijon:

a) Programi i punësimit është një program 4, 8 ose 12-mujor punësimi, në të cilin profili dhe nevojat e punëkërkuarës përshtaten me vendin e lirë nga punëdhënësi;

b) Paga përcaktohet në kontratën e punës, në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg.

2. Programi subvencionon kostot e mëposhtme:

a) Për programin e punësimit katërmujor:

i. financimin e pagës në shumën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për 2 (dy) muaj për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuar në muajin e parë dhe të katërt të kontratës;

ii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuar çdo muaj.

b) Për programin e punësimit tetëmuajor:

i. financimin e pagës në shumën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për 4 (katër) muaj, për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuar në muajin e parë, të dytë, të shtatë dhe të tetë të kontratës;

ii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuar çdo muaj.

c) Për programin e punësimit 12 (dymbëdhjetë) muajor subvencionon kostot e financimit të sigurimeve të detyrueshme (kontribut i punëdhënësit dhe punëmarrësit) në masën 100%, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit, të kompensuar çdo muaj.

IV. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT

Procedura e përgjithshme e zbatimit të këtyre programeve përfshin hapat, si më poshtë vijon:

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, nëpërmjet strukturave të tij, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtyp etj.) lidhur me zbatimin e programit.

2. Punëdhënësit mund të kërkojnë për përfshirjen në program në rrugë elektronike, duke ngarkuar në faqen e internetit:

a) formularin përkatës të plotësuar, sipas modelit standard të miratuar dhe të publikuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;

b) autorizimin e punëdhënësit, me të cilin autorizohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për të kryer të gjithë verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të të dhënave të kërkesës;

c) vetëdeklarim për mospasjen në ngarkim të punëdhënësit, të shkeljeve apo të sanksioneve që lidhen me legjislacionin e punës, përgjatë dy viteve të fundit.

3. Pas marrjes së kërkesës nga punëdhënësi, struktura vendore e punësimit kryen verifikimet e nevojshme.

4. Struktura vendore e punësimit verifikon, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, plotësimin e kushteve formale paraprake të kërkesës dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatueshme të programit.

5. Në rast të mosplotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore e punësimit i kërkon kërkuarës plotësimin e dokumentacionit.

6. Në rast të plotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore i përcjell për miratim kërkesën strukturës rajonale të punësimit, e cila, brenda 5 (pesë) ditëve pune, vendos miratimin ose mosmiratimin e projektit, sipas rregullave të përcaktuara në manualin e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit.

7. Struktura vendore e punësimit i komunikon punëdhënësit kërkesë përgjigjen përfundimtare për pranimin apo refuzimin e kërkesës, brenda 2 (dy) ditëve pune. Ndaj këtij vendimi nuk paraqitet ankim administrativ.

8. Punëdhënësi dhe punëkërkesi, në cilësinë e punëmarrësit, lidhin një kontratë pune, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, në përputhje me programin e përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi. Një kopje e kontratës së punësimit dorëzohet në strukturën vendore të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili do të monitorojë zbatimin e saj deri në përfundim të projektit.

9. Pas nënshkrimit të kontratës së punës nënshkruhet marrëveshja tripalëshe për zbatimin e programit.

10. Nëse punëdhënësi zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën me përfituesin për shkaqe të pajustificuara, punëdhënësi është i detyruar të kthejë 100% të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment.

11. Nëse punëdhënësi nuk respekton marrëveshjen tripalëshe për zbatimin e programit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, ai përjashtohet nga pjesëmarrja në program për një periudhë katërvjeçare.

12. Financimi i punëdhënësit do të bëhet çdo muaj, pas verifikimit nga struktura përkatëse e punësimit të kryerjes së pagesës nga ana e tij.

13. Monitorimi i zbatimit kryhet nga strukturat përkatëse të punësimit (institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë).

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Afati i zbatimit të kësaj skeme është deri më 31 dhjetor 2021. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përgatit raportin vjetor, brenda datës 31 marsit të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ruan të dhënat për programet 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Vlerësimi i ndikimit të programit kryhet 2 (dy) vjet pas zbatimit të tij, nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

4. Ngarkohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për hartimin e rregulloreve të zbatimit të programit të nxitjes së punësimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe